

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI POPULLOR

LIGJI
PER PRONESINE INDUSTRIALE

Ne mbeshtetje te Nenit 16 te ligjit nr. 7491, date 29. 04. 1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1
Objekti

Ky Ligj siguron dhenien dhe mbrojtjen e te drejtave te Pronesise Industriale per keto objekte:

- 1.Shpikjet dhe modelet e perdorimit.
- 2.Markat Tregtare dhe te Sherbimit.
- 3.Dizenjot Industriale.
- 4.Emertimet e origjines.

Neni 2
Format e mbrojtjes

(1) Shpikjet dhe modelet e perdorimit mbrohen me anen e patentave, qe leshohen nga Zyra e Patentave.
Dizenjot industriale, markat tregtare e te sherbimit dhe emertimet e origjines mbrohen me anen e regjistrimit ne Zyren e Patentave.

Mbrojtja e referuar ne kete paragraf ne lidhje me dizenjot industriale nuk perjashton ndonje te drejte tjeter te parashikuar me ligj, dhe ne vecanti te drejtat e bazuara ne Ligjin per te Drejten e Autorit.

(2) Klauzolat e ketij Ligji jane njelloj te vlefshme dhe te zbatueshme edhe per personat fizike dhe juridike te huaj:

(a) prej shteteve qe jane pale-kontraktuese ne traktate dhe konventa nderkombetare ne fushen e pronesise industriale, ne te cilat ben pjese edhe Republika e Shqiperise;

(b) prej vendeve, me te cilat zbatohet parimi i reciprocitetit ne fushen e pronesise industriale, ne kuadrin e marredhenieve dypaleshe ose ne shkalle rajonale me efekt per Republikën e Shqiperise.

Ekzistenca e reciprocitetit duhet te provohet nga pala e cila kerkon reciprocitet.

PJESA I

PATENTAT PER SHPIKJET DHE MODELET E PERDORIMIT

KAPITULLI I
PATENTUESHMERIA E SHPIKJEVE

Neni 3
Kushtet e patentueshmerise

(1) Nje shpikje eshte e patentueshme ne qofte se:

- perben nje novacion;
- permban ne vetvete nje hap shpikes (qe nuk eshte i dukshem per cilindo) dhe eshte e zbatueshme ne industri.

(2) Paragrafi i mesiperme nuk zbatohet per :

- (a) zbulimet, teorite shkencore dhe metodat matematike;